



## PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

**Nr. 25**

Datë: 23. 09. 2022. Ora: 14: 30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Alim Rama, Ilir Gashi, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj dhe Rifat Krasniq.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Nexhmedin Hyseni, drejtor i ZRPP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### RENDI I DITËS

**1. Hyrje: z. Alim Rama, anëtarë i KQZ-së:**

**2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes Nr.21/2022.**

**3. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

**3.1.Këshilli për Operacione Zgjedhore;**

*3.1.1. Prezantimi i ri dizajnit të ueb faqes së KQZ-së*

*3.1.2 Shqyrtimi dhe miratimi i përmbajtjes dhe dizajnit të fletushkës për votuesit e rinj për zgjedhje*

**Të ndryshme !**

## **1. Hyrje: z. Alim Rama, anëtarë i KQZ-së:**

**Alim Rama:** Me autorizimin e kryesuesit të KQZ-së, unë sot do ta udhëheq mbledhjen.... A ka dikush ndonjë propozim...?

**Burim Ahmetaj:** Ligji për financat publike ka hy në fuqi me datën 20, e lidhur me këtë është formuar një komision, kishim dashur me ju informue se çka e obligon ky ligj KQZ-në...

Afati është 20 ditë, ju vendosni...

Alim Rama: Mendoj që ligjin ta diskutojmë kur të kthehet kryetari !

**Sami Hamiti:** Po, e kam lexue dhe mendoj që ka me na u dashtë me e analizue, ka dy –tri pika që kanë me u dashtë...

Edhe Ilir Gashi, kërkoi që të diskutohet kur të kthehet kryetari, kurse anëtari Çemajl Kurteshi tha se mund ta kemi si informatë, por që ta diskutojmë ligjin...? Shohim, po kryesorja mund ta dëgjojmë nga krye shefi si informacion...

Arianit Elshani, pyeti rreth prezantimit të dizajnit të ueb faqes, ose ta trajtojmë...?

Në vazhdim të mbledhjes, anëtarët e KQZ-së miratuan rendin e ditës të mbledhjes, dhe miratuan procesverbalet nr. 21, 22 dhe 23/2002 nga mbledhjet e KQZ-së.

## **2.Raport i Këshillave të KQZ-së**

### **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

Shqyrtimi dhe miratimi i përmbajtjes dhe dizajnit të fletushkës për votuesit e rinj për zgjedhje:

**Arianit Elshani**, tha se këshilli ka shqyrtuar përmbajtjen dhe dizajnin e Fletushkës për Votuesit e Rinj për Zgjedhje lidhur me aktivitetet që do të zhvillohen në shkollat e mesme dhe me maturantët në mbarë Kosovën. “Jemi munduar që përmbajtja të jetë më shumë në aspektin motivues me të rinjtë, të cilëve do tu shpjegohet e drejta e votës, pse duhet të votojnë, për numrin e kandidatëve që duhet të votojnë etj. Kjo është një mostër, me dy versione të dizajnit e miratuar më herët nga KQZ për zgjedhjet parlamentare. Sigurisht që ky fletëvotim, do ti nënshtrohet diskutimit në KQZ, por edhe në diskutimet për ligjin e zgjedhjeve, sepse ky format ka rëndësi.

E keni edhe dizajnin, dhe këshilli rekomandon aprovimin e fletushkës”, shpjegoi z. Elshani.

**Ilir Gashi:** E mbështes punën e komisionit. Por, çështja e dizajnit tha se është goxha subjektive. Të rinjtë, mbase e kuptojmë më mirë dizajnin, të rinjtë i kuptojnë versionet, të dyjat por ne kemi problem me gjeneratat e vjetra...Ndoshta, me gjeneratën e vjetër ishte dashur të provohet, sido qoftë, e mbështesë faqen e parë, pra, ne duhet me pas një mostër...

Anëtarët e KQZ-së, Alim Rama, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Sami Hamiti, Alim Rama dhe Sami Kurteshi, e analizuan më shumë “Fletëvotimin”, sidomos në aspektin e “relacioneve dhe refleksioneve” që sjellë tek votuesi “përmbajtja” por “edhe “dizajni” në mënyrë që, “fletëvotimi” të jetë sa më i lehtë, kompakt dhe në shërbim të procesit...

Në fund, anëtarët e KQZ-së, edhe me vërejtjet e bëra sidomos rreth “përmbajtjes” së shkruar u pajtuan në parim dhe miratuan formatin e këtij “fletëvotimi”, s’i dhe materialet lidhur me promovimin e tyre me shkollarët e mesëm dhe maturantët.

### **Të ndryshme !**

**Sami Kurteshit,** foli rreth tryezës së mbajtur sot lidhur me prezantimin e Strategjisë së KQZ-së, dhe ai tha se, i vjen keq (turp) me prezantimin e bërë...

“Sot, ishte prezantimi i strategjisë, domethënë i punës tonë dhe jo aspekti teorik i zgjedhjeve! Ne, kemi mundësi me e bërë këtë, por ai nuk ishte prezantim...”, tha z. Kurteshi.

**Sami Hamiti:** Shkurt po ju njoftoj se ishim me zëvdnëskryeshefin dhe drejtoreshën e DAP-it në dëgjim buxhetor në MEF (Ministrinë e Financave). Ua kemi paraqitë pak a shumë raportin tonë çka kemi ba, projektet kapitale, dhe rritjen me 10% për subvencionim të partive politike si propozim i KQZ-së... Këtë të fundit e kemi miratua unanimisht, por që ka qenë kërkesë e subjekteve politike dhe jo, e jona...

Secilin pozicion, ua kemi shpjegue veç e veç, dhe kemi përshtypjen se nga ana e tyre kërkesat tona janë të arsyeshme, të mirë kuptueshme...

Nexhmedin Haxhiu, foli rreth ligjit financimit të partive politike ka hy në fuqi. Zyra ka filluar punën, dhe ne kemi identifikuar 11 draft - rekomandime, e 7 komente...

Por, janë 3 nene të ligjit që, duhet të kërkojmë ndihmë nga institucionet tjera, dhe 2 nene janë kundërthënëse brenda ligjit. Javën tjetër, besoj se do ta përcjellim...

Informacion tjetër është se, të hënën jemi të ftuar nga MPB lidhur me ligjin për pagat...

Alim Rama, tha se komenti im është për kryeshefin: faktura e Llaptovave nuk është paguar dhe, shkon në përmbarrim. Kisha kërkue që të diskutohet në Këshill për Buxhet. Për mue, është absurde: ka një problem me kontratën, dhe shkon në përmbarrim...

( pothuajse në fund të mbledhjes, nga këtu, stenogrami ka ndërprerje...)